



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË  
ARSIMIN E LARTË**

Vlerësimi Institucional i Institucioneve të Arsimit të  
Lartë në Shqipëri

**Raport i Akreditimit Institucional të  
Universitetit të Sporteve të Tiranës**

**Shtator 2021**

**GRUPI I VLERËSIMIT:**

1. Grant Horsburgh Kryetar
2. Chris Richter Anëtar
3. Gjergji Thomai Anëtar

<b>Tabela e përmbajtjes</b>	
<b>Rreth këtij vlerësimi .....</b>	<b>5</b>
<b>Konteksti i këtij vlerësimi .....</b>	<b>6</b>
<b>Raporti përmbledhës .....</b>	<b>7</b>
<b>Përmbledhje e gjetjeve .....</b>	<b>9</b>
Praktika e mirë .....	9
Pikat e dobëta.....	10
Rekomandimet .....	10
Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë.....	10
Gjykime përmbledhëse për çdo Fushë Vlerësimi.....	10
Gjykim i përmbledhur.....	10
<b>Raport i detajuar .....</b>	<b>12</b>
<b>Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij .....</b>	<b>12</b>
<b>Gjetjet .....</b>	<b>14</b>
Praktika e mirë .....	14
Pikat e dobëta.....	14
Rekomandimet .....	14
Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë.....	14
Gjykimi .....	14
<b>Fusha e Vlerësimit 2: Burimet.....</b>	<b>15</b>
<b>Gjetjet .....</b>	<b>17</b>
Praktika e mirë .....	17
Pikat e dobëta.....	17
Rekomandimet .....	17
Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë.....	17
Gjykimi .....	17
<b>Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula.....</b>	<b>19</b>
<b>Gjetjet .....</b>	<b>20</b>
Praktika e mirë .....	21
Pikat e dobëta.....	21
Rekomandimet .....	21
Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë.....	21
Gjykimi .....	21
<b>Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi.....</b>	<b>22</b>
<b>Gjetjet .....</b>	<b>24</b>
Praktika e mirë .....	24
Pikat e dobëta.....	24
Rekomandimet .....	24
Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë.....	24
Gjykimi .....	24
<b>Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe mbështetja e tyre.....</b>	<b>25</b>
<b>Gjetjet .....</b>	<b>26</b>
Praktika e mirë .....	26
Pikat e dobëta.....	27
Rekomandimet .....	27
Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë.....	27
Gjykimi .....	27
<b>Lista e evidencave .....</b>	<b>28</b>
Lista 1.....	28

<b>Rekomandimet .....</b>	<b>28</b>
<b>Fusha e Vlerësimit 1 .....</b>	<b>28</b>
<b>Fusha e Vlerësimit 2 .....</b>	<b>30</b>
<b>Fusha e Vlerësimit 3 .....</b>	<b>31</b>
<b>Fusha e Vlerësimit 4 .....</b>	<b>32</b>
<b>Fusha e Vlerësimit 5 .....</b>	<b>33</b>
<b>Shtojcat.....</b>	<b>33</b>
<b>Mbledhjet e zhvilluara gjatë vizitës .....</b>	<b>34</b>

## **Rreth këtij vlerësimi**

Qëllimi kryesor i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë se në çfarë shkalle institucionet e arsimit të lartë (IAL-të) përmbushin Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri, që hynë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është procesi i vlerësimit nga grupi i ekspertëve të vlerësimit, që përbëhet nga një ndërthurje e ekspertëve ndërkombëtarë dhe Shqiptarë të caktuar nga ASCAL.

Raportet përkatëse nuk shërbejnë vetëm për akreditimin institucional, që bazohet në shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-të, por edhe për t'iu ofruar IAL-ve, qeverisë shqiptare, publikut dhe studentëve informacion për mënyrën se si IAL-të përmbushin standardet. Ky raport i ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë prioritetet që kanë nevojë për përmirësim (procesi që ofruesit e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxënit të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar në pesë kapituj, Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave të mira, rekomandimet, pohimet e veprimeve në zhvillim e sipër dhe pikat e dobëta për çdo Fushë Vlerësimi, duke përfshirë gjykimin se në çfarë niveli IAL-ja i përmbush standardet. Format e gjykimit që ekspertët mund të japin janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Së fundi, vlerësuesit e përbyllin procesin duke rekomanduar një gjykim përmbledhës për Bordin e Akreditimit të ASCAL-it. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

## Konteksti i këtij vlerësimi

Universiteti i Sporteve të Tiranës (UST) është i vetmi institucion i arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë që ofron nivele studimi të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë për mësues të edukimit fizik dhe specialistë sporti. UST-së i është dhënë titulli aktual nga Këshilli i Ministrave në vitin 2010. Megjithatë, origjina e institucionit daton në vitin 1948, dhe më pas u njoh si Teknikumi i Edukimit Fizik.

Në kohën e këtij vlerësimi, UST-ja përbëhet nga katër njësi kryesore dhe 12 departamente, si më poshtë: Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes (Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit, Departamenti i Mjekësisë Sportive dhe Departamenti i Sportit), që përgatit mësues të edukimit dhe shëndetit fizik; Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit (Departamenti i Veprimtarisë Fizike, Rekreacionit dhe Turizmit, Departamenti i Organizim-Menaxhimit dhe Departamenti i Lëvizjes dhe Shëndetit), që përgatit trajnerë fitnesi dhe menaxherë sporti dhe turizmi; Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit (Departamenti i Disiplinave Biomjekësore dhe Humane, Departamenti i Kineziologjisë dhe Departamenti i Rehabilitimit), që u hap në vitin 2020 dhe përgatit specialistë rehabilitimi; dhe Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit (Departamenti i Performancës Sportive, Departamenti i Aktivitetit Fizik dhe Shëndetit dhe Departamenti i Projekteve dhe Teknologjisë). **[RVV, f. 5&6].** Gjithashtu, janë edhe 17 njësi administrative. UST-ja ka 42 anëtarë personeli akademik me kohë të plotë dhe ofron tre programe studimi të ciklit të parë, pesë të ciklit të dytë dhe dy programe studimi të ciklit të tretë. **[Informacion për IAL-të në sistemin SMA].** Në këtë universitet studiojnë 1,027 studentë të ciklit të parë, 46 studentë në Master Shkencor dhe 397 studentë të regjistruar në Master Profesional. **[Informacion për IAL-të në sistemin e ASCAL-it]**

## Raporti përmbledhës

Universiteti i Sporteve të Tiranës (UST) është institucion publik me godina të vendosura në qendër të qytetit, i cili ushtron veprimtarinë e tij në formën aktuale që nga viti 2010. Në kohën e kryerjes së vlerësimit, UST kishte rreth 1,470 studentë dhe ofronte nëntë programe studimi për të tria ciklet. Universiteti ka 42 pedagogë me kohë të plotë të organizuar në katër njësi kryesore, si më poshtë: Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit dhe Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit.

Ky është Vlerësimi i dytë Institucional për UST-në, për të vlerësuar se deri në çfarë shkalle janë përmbushur Standardet Shtetërore të Cilësisë, që hynë në fuqi në vitin 2011. Raporti i vlerësimit të parë të jashtëm në muajin qershor të vitit 2017 nuk përfshiu asnjë karakteristikë të praktikës së mirë dhe nuk u konfirmua asnjë veprim në proces, por u dhanë nëntë rekomandime që UST-ja të merrte parasysh për trajtimin e fushave të identifikuara të pikave të dobëta. Raporti përcaktoi gjykimet e mëposhtme për secilën Fushë Vlerësimi:

- Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përmbushur kryesisht**.
- Standardet për Burimet janë **përmbushur kryesisht**.
- Standardet për Kurrikulën janë **përmbushur plotësisht**.
- Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përmbushur kryesisht**.
- Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përmbushur kryesisht**.

Në qershor të vitit 2017, vlerësuesit i rekomanduan Këshillit të Akreditimit se UST-ja i kishte **përmbushur kryesisht Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri dhe për rrjedhojë UST-së iu dha akreditimi nga Këshilli për një periudhë trevjeçare. Në tetor të vitit 2017, Bordi i Akreditimit renditi gjashtë rekomandimet që UST-ja duhet të merrte parasysh dhe të trajtonte. Veprimet e ndërmarra nga UST-ja në këtë drejtim trajtohen sipas Standardeve Shtetërore të Cilësisë gjatë gjithë këtij raporti.**

Ekipi i përbërë nga drejtues të lartë, akademikë, stafi mbështetës dhe një përfaqësues i studentëve hartoi një Raport vetëvlerësimi. Procesi i vetëvlerësimit përfshinte prova të mbledhura nga njësitë akademike dhe administrative, intervistat, tryezat e rrumbullakëta dhe pyetësorët me palët e interesit në UST. Në muajin maj 2021 u mbajt një ditë informuese me fokus grupe për shqyrtimin e raportit. Reagimet dhe komentet e marra ndihmuan me hartimin e versionit përfundimtar të Raportit të Vetëvlerësimit.

Vizita u krye gjatë dy ditëve, në datat 24 dhe 25 qershor të vitit 2021. Grupi i Vlerësimit përbëhej nga një vlerësues i nivelit të lartë për arsimin e lartë nga Mbretëria e Bashkuar, një vlerësues akademik i nivelit të lartë nga Gjermania dhe një vlerësues akademik i nivelit të lartë, pjesë e personelit të një institucioni shqiptar. Ndonëse dy vlerësuesit akademikë të nivelit të lartë ishin të pranishëm në UST gjatë vizitës, Kryetari nga Mbretëria e Bashkuar mori pjesë nëpërmjet një linku online. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u mbështet nga Menaxheri për Vlerësimin e Jashtëm i punësuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mori Raportin e Vetëvlerësimit dhe portofolin me të dhënat mbështetëse katër javë përpara vizitës së Grupit të Vlerësimit të

Jashtëm, më pas i plotësuar me dokumentacion shtesë gjatë vizitës. Një gamë e gjerë informacioni mbështetës, i siguruar nga UST-ja, i mundësoi grupit të njihej me strukturën, politikat dhe procedurat e menaxhimit, dhe me natyrën e mësimdhënies dhe veprimtarisë kërkimore të ndërmarrë nga institucioni. Këto dokumente përfshinin Statutin dhe Rregulloret, raportet e brendshme, raportin vjetor ndaj Ministrisë, procedurat e pranimit dhe orientimit, listën e marrëveshjeve të jashtme dhe memorandumëve, shembujt e informacioneve rreth programit, si dhe dokumentet e mbledhjeve vendimmarrëse.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me menaxherë të nivelit të lartë, studentë, pedagogë, personelin administrativ dhe mbështetës, si dhe partnerë të jashtëm gjatë vizitës së vlerësimit të jashtëm. Diskutimi shërbeu për qartësimin e procedurave, përgjegjësive dhe pikëpamjeve. Në të gjitha mbledhjet u mbajtën shënime. Si pjesë të turit të kampusit kryesor, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi bibliotekën, ambientet e mësimdhënies, laboratorët, ambientet sportive dhe zyrat.

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përbushur plotësisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë, nuk identifikoi asnjë dobësi, nuk dha asnjë rekomandim dhe nuk pohoi asnjë veprim tashmë të ndërmarrë. Gjatë procesit të vlerësimit, UST-ja ofroi evidenca të mjaftueshme për të dëshmuar angazhimin e saj në trajtimin e çështjeve të diskutuara në raportin që rezultoi nga vizita e akreditimit e prillit të vitit 2017. Si rrjedhojë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti të konfirmonte se përfshirja e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe politikave dhe procedurave shoqëruese trajton plotësisht rekomandimin e dhënë pas vizitës së akreditimit institucional në muajin prill të vitit 2017 (**Kapitulli III, Standardi I.4**).

Standardet për Burimet janë **përbushur plotësisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk konstatoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë apo pika të dobëta, por dha një **rekomandim** sipas të cilit UST-ja duhet të marrë në konsideratë shqyrtimin e përshtatshmërisë së synimeve aktuale të produkteve kërkimore të stafit në politikat ekzistuese të vlerësimit periodik të stafit. (**Kapitulli III, Standardi IV.3**). UST-ja ka një objektiv zhvillimi institucional për të siguruar se i gjithë arkivi i UST-së do të digjitalizohet deri në fund të vitit 2021 dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **ripohon** këtë veprim. (**Kapitulli III, Standardi V.2**). Menaxhimi i sistemit të informacionit të universitetit për të siguruar se informacioni dhe të dhënat janë strategjike dhe të përshtatshme trajton plotësisht rekomandimin e dhënë pas vizitës së akreditimit institucional në muajin prill të vitit 2017. (**Kapitulli III, Standardi VII.2**) dhe turi në burimet e të nxënit konfirmoi se rekomandimi i dhënë pas vizitës së akreditimit institucional të muajit prill të vitit 2017, sipas të cilit Universiteti duhet të hartojë dhe zbatojë një plan të përcaktuar për të siguruar se studentët me aftësi të kufizuara do të mund të aksesojnë të gjitha hapësirat e të nxënit dhe mësimdhënies, është trajtuar plotësisht. (**Kapitulli III, Standardi VII.3; Kapitulli III, Standardi VII.5; Kapitulli III, Standardi V.1**) Zbatimi i Politikës së Menaxhimit të Pasurive trajton plotësisht rekomandimin e dhënë pas vizitës së akreditimit institucional të muajit prill 2017 se UST-ja duhet të sigurojë infrastrukturën e duhur në nivel universiteti për përmirësimin e kushteve të mësimdhënies dhe menaxhimin efikas të infrastrukturës për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. (**Kapitulli III, Standardi VII.3; Kapitulli III, Standardi VII.5; Kapitulli III, Standardi V.1**)



Standardet për Kurrikulën janë **përbushur plotësisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë, nuk identifikoi asnjë dobësi, nuk dha asnjë rekomandim dhe nuk pohoi asnjë veprim tashmë të ndërmarrë. Gjatë procesit të vlerësimit, UST-ja ofroi evidenca të mjaftueshme për të dëshmuar angazhimin e saj në trajtimin e çështjeve të diskutuara në raportin që rezultoi nga vizita e akreditimit e shtatorit të vitit 2016. Si rezultat, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mundi të konfirmonte se Standardet Shtetërore të përfshira në Fushën e Vlerësimit 3 janë trajtuar plotësisht.

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur plotësisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë, nuk identifikoi asnjë dobësi, nuk dha asnjë rekomandim dhe nuk pohoi asnjë veprim tashmë të ndërmarrë. Gjatë procesit të vlerësimit, UST-ja ofroi evidenca të mjaftueshme për të dëshmuar angazhimin e saj në trajtimin e çështjeve të diskutuara në raportin që rezultoi nga vizita e akreditimit e shtatorit të vitit 2016. Si rezultat, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mundi të konfirmonte se Standardet Shtetërore të përfshira në Fushën e Vlerësimit 4 janë trajtuar plotësisht.

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur plotësisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë ose pika të dobëta, dhe nuk dha asnjë rekomandim. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **riponon** zbatimin e propozuar të projektidesë 'Studenti për studentin' ku studentët me rezultatet më të larta do të ndihmojnë studentët e tjerë në nevojë (**Kapitulli I, Standardi III.6**). UST-ja, së bashku me studentët dhe KVMMS-në, është duke krijuar një Këshill Studentor të ri dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **riponon** këtë veprim. (**Kapitulli I, Standardi III.7**). Gjithashtu, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **riponon** veprimin e ndërmarrë për të krijuar plotësisht një bazë të dhënash efektive të të diplomuarve në UST. (**Kapitulli I, Standardi III.9**). Megjithatë rekomandimi i bërë pas vizitës së akreditimit institucional të prillit të vitit 2017 se UST-ja duhet të ndërtojë dhe krijojë një bazë të dhënash gjithëpërfshirëse dhe të përhershme për ndjekjen e punësimit të të gjithë studentëve të diplomuar është plotësuar pjesërisht, mbështetja financiare e ofruar për Këshillat Studentorë të Universitetit dhe Fakulteteve trajton plotësisht rekomandimin e bërë pas vizitës së akreditimit institucional të prillit të vitit 2017.

UST-ja kreu vetëvlerësimin në përputhje me udhëzimet e ASCAL-it. Grupi i vlerësimit vlerësoi shkallën e angazhimit të Universitetit në proces dhe bashkëpunimin që iu ofrua përgjatë fazës së vizitës. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga Z. Grant Horsburgh (Kryetar), Dr. Chris Richter dhe Dr. Gjergji Thomai (Vlerësues të Jashtëm).

## **Përmbledhje e gjetjeve**

### **Praktika e mirë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- ndërkombëtarizim përmes marrëveshjeve me institucione të tjera dhe pjesëmarrjes në projekte **(Kapitulli II, Standardi I.3)**
- ngritje e Komisionit të Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët për të përkrahur studentët dhe për të trajtuar problemet e tyre në organet përkatëse **(Kapitulli I, Standardi III.2; Kapitulli I, Standardi III.3)**.

### **Pikat e dobëta**

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

### **Rekomandimet**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- UST-ja duhet të marrë në konsideratë shqyrtimin e përshtatshmërisë së synimeve aktuale të produkteve kërkimore të stafit në politikat ekzistuese të vlerësimit periodik të stafit. **(Kapitulli III, Standardi IV.3)**.

### **Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë**

Grupi i vlerësimit të jashtëm pohoi veprimin e mëposhtëm të ndërmarrë:

- veprimi i ndërmarrë për të realizuar digjitalizimin e të gjithë arkivit të UST-së deri në fund të vitit 2021 **(Kapitulli III, Standardi V.2)**
- zbatimin e propozuar të projektidesë 'Studenti për studentin' ku studentët me rezultatet më të larta do të ndihmojnë studentët e tjerë në nevojë **(Kapitulli I, Standardi III.6)**
- veprimi i ndërmarrë për të ngritur një Këshill Studentor të ri **(Kapitulli I, Standardi III.7)**
- veprimi i ndërmarrë për të krijuar plotësisht një bazë të dhënash efektive të të diplomuarve në UST. **(Kapitulli I, Standardi III.9)**.

### **Gjykime përmblendhëse për çdo Fushë Vlerësimi**

1. Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përbushur plotësisht**.
2. Standardet për Burimet janë **përbushur plotësisht**.
3. Standardet për Kurrikulën janë **përbushur plotësisht**.
4. Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur plotësisht**.
5. Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur plotësisht**.

### **Gjykim i përmblendhur**

Vlerësuesit i rekomandojnë Bordit të Akreditimit se Standardet Shtetërore të Cilësisë janë **përbushur plotësisht** në Universitetin e Sporteve të Tiranës.



## Raport i detajuar

### Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

- 1.1 Kornizat rregullatore dhe të qeverisjes së UST-së janë krijuar për t'u bashkërenduar me kërkesat ligjore kombëtare për institucionet e arsimit të lartë. **[RVV f. 11; Ref. 1.2-1.10; Mbledhjet 5,6,7,10&13]** Statuti përcakton vizionin, misionin, organizimin e brendshëm dhe strukturat e menaxhimit. **[Ref.1.2, Nenet 4,5,10-14]** Në rregullore përcaktohen edhe përgjegjësitë individuale dhe formale të bordit dhe këshillit. **[Ref.1.2, Nenet 18-39; Ref 1.3, Nenet 3-20]** UST kryen ndryshime të Statutit dhe rregulloreve të tij sipas nevojës. **[RVV f. 11; Ref 1.12]** Bordi i Administrimit dhe Senati Akademik kanë miratuar Statutin për të marrë parasysh ligjin e arsimit të lartë. **[RVV f. 11; Ref 1.12] (Kapitulli III, Standardi I.1)**
- 1.2 UST-ja është e organizuar për të siguruar efikasitet në menaxhim në përputhje me kërkesat ligjore dhe planet strategjike të miratuara **[RVV f. 11-13; Ref 1.2,1.3,1.24-1.27; Mbledhja 10]** Rrjedha e informacionit nga njësitë bazë në Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit, dhe shpallja e vendimeve të tyre për dijeni të stafit dhe studentëve, është e efektshme. **[Mbledhjet 3-7&13]** Rregullimet për menaxhimin dhe administrimin e institucionit dhe vendimmarrjen kolegjiale marrin parasysh pritshmëritë ligjore, funksionojnë sipas parashikimit dhe kuptohen nga stafi. **[RVV f.11-13; Ref 1.2,1.3,1.24-1.27; Mbledhjet 5&6] (Kapitulli III, Standardi I.2)**
- 1.3 Organet drejtuese mbledhen rregullisht dhe informacionet mbi zërat e rendit të ditës i vihen në dispozicion paraprakisht të gjithë stafit në mënyrë elektronike. **[RVV f. 13,14&16; Mbledhjet 6&7]** Stafi dhe studentët i kuptojnë rregullimet për funksionimin e këshillave dhe bordeve vendimmarrëse dhe për mbështetjen e diskutimit dhe debatit kolegjial dhe ato janë të përcaktuara edhe në rregullore. **[RVV f. 13,14&16; Ref 1.2,1.3,1.24-1.27; Mbledhjet 3-7]** Dekanët dhe përgjegjësit e departamenteve janë të përgjegjshëm për monitorimin lokal të zbatimit të vendimeve të marra nga bordet dhe këshillat e ngritur zyrtarisht. **[RVV f.13,14&16; Ref 1.2,1.3,1.24-1.27; Mbledhja 10] (Kapitulli III, Standardi I.3; Kapitulli III, Standardi II.3)**
- 1.4 UST-ja siguron se kufijtë e autonomisë së vet respektohen dhe se funksionon brenda kornizave të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi. **[RVV f.14; Ref 1.2, Neni 7; Mbledhja 10]** Vetëqeverisja është e dukshme në njësitë organizative akademike dhe administrative, në veprimtaritë mësimore dhe shkencore, si dhe në çështjet financiare dhe administrative. **[Mbledhja 10]** Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë luan rol kyç në monitorimin dhe analizimin e efektshmërisë së veprimtarive të vlerësimit të brendshëm. **[RVV f.14; Ref 1.21]** Përfshirja e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka pasur synim trajtimin e rekomandimit të dhënë pas vizitës së akreditimit të prillit të vitit 2017, për të trajtuar ngritjen e një njësie mbikëqyrëse të brendshme si çështje prioritare, për kryerjen e vlerësimit të brendshëm të veprimtarive institucionale, si dhe identifikimin e konsulentëve të jashtëm për të ndihmuar me këto procese. **[RVV f. 7,8&14; Ref 1.20&1.20.a; Mbledhjet 7,10&13]** Përfshirja e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe politikave dhe procedurave shoqëruese trajton plotësisht rekomandimin e dhënë pas vizitës së akreditimit institucional të muajit prill 2017. **(Kapitulli III, Standardi I.4)**

- 1.5 UST-ja ka një strategji të përshtatshme zhvillimi të quajtur *Plani i Zhvillimit Strategjik 2021-2026*, që është miratuar nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit. Ky dokument bazohet në *Planin Strategjik 2016-2020* dhe mbështetet nga dokumente të tjera strategjike që lidhen me ndërkombëtarizimin dhe kërkimin shkencor. **[RVV f.14&15; Ref 1.24-1.27; Mbledhjet 2,12&13]** Strategjia është hartuar në përputhje me misionin dhe objektivat e UST-së dhe u shqyrtua gjatë fazave të ndryshme të hartimit nga organet drejtuese dhe këshillat. **[RVV f.14&15; Mbledhjet 2,12&13] (Kapitulli III, Standardi I.5)**
- 1.6 Raporti vjetor që i dorëzohet Ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë hartohet nga Rektorati duke u mbështetur në raportet vjetore të fakulteteve dhe paraqet të dhëna mbi mësimdhënien dhe programet e studimit, kërkimin shkencor, punësimin e stafit, veprimtarinë e projekteve dhe çështjet ekonomike dhe financiare. **[RVV f.15; Ref 1.28&1.29]** Projektraporti diskutohet në një forum të Senatit Akademik, të hapur për të gjithë stafin, studentët dhe palët e tjera të interesit. **[RVV f. 15]** Pikat e dakordësuara gjatë forumit të hapur shërbejnë për hartimin e raportit përfundimtar, që publikohet në faqen e internetit të institucionit. **[www.ust.edu.al] (Kapitulli III, Standardi I.6)**
- 1.7 Fakultetet dhe departamentet janë organizuar në përputhje me kërkesat ligjore. **[RVV f. 15&16; Ref 1.2,1.3,1.24-1.27; Informacioni për IAL-të në sistemin SMA; Mbledhjet 6&7]** Strukturat drejtuese, ekzekutive dhe administrative janë të ndara nga strukturat akademike dhe njësitë organizative. **[Mbledhjet 6&7,10&13]** Personeli akademik është i kualifikuar dhe ushtron autonomi dhe liri akademike në mësimdhënie, kërkim dhe veprimtari të tjera akademike. **[Mbledhjet 6&7,11&13]** UST-ja ka një faqe interneti zyrtare dhe ofron programe të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë në përputhje me statusin e vet ligjor. **[RVV f. 15&16; Ref 1.2,1.3,1.24-1.27; Informacioni për IAL-të në sistemin SMA; www.ust.edu.al; Mbledhjet 3-5] (Kapitulli III, Standardi II.1)**
- 1.8 UST-ja ka një rrjet partnerësh në nivel kombëtar dhe rajonal, ku përfshihen institucione të arsimit të lartë, organe publike dhe firma të pavarura. **[RVV f.17&18; Mbledhjet 3-6,10-12]** Ndërkombëtarizimi është përfshirë si një veçori kyçe në *Planin Strategjik 2021-2026* dhe mbështetet nga *Strategjia e Ndërkombëtarizimit 2021-2023*. **[RVV f.17&18; Ref 1.25&1.26]** Raporti i Vetëvlerësimit identifikoi një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare. **[RVV f. 17&18; Ref 1.22-1.23.d]** Studentët, stafi akademik, alumnit dhe përfaqësuesit e industrive u shprehën se ekzistojnë lidhje të forta ndërmjet organizatave vendore dhe rajonale dhe stafit akademik të Njërive Kryesore dhe atyre Bazë. **[Mbledhjet 3-7,10&11. (Kapitulli III, Standardi III.1; Kapitulli III, Standardi III.2)**
- 1.9 UST-ja ka lidhur marrëveshje partneriteti me institucione shtetërore dhe private për të ofruar shërbime për studentët dhe për të siguruar se programet e tij të studimit përmirësohen dhe përshtaten për të përmbushur nevojat dhe pritshmëritë e tyre. **[RVV f.18; Ref 1.23&1.23.c; Mbledhjet 6,7&10,11&13] (Kapitulli III, Standardi III.3)**
- 1.10 UST-ja ka lidhur një sërë marrëveshesh formale, që u bëjnë të mundur stafit dhe studentëve të marrin pjesë në veprimtari ndërkombëtare. **[RVV f.17&18; Ref 1.23; Mbledhjet 3-7,10&11]** Studentët dhe stafi konfirmuan se ishin në dijeni të mundësive për të marrë pjesë në veprimtari ndërkombëtare dhe se UST-ja i inkurajonte dhe mbështeste aplikimet. **[RVV Mbledhjet 3-7]** Personeli i nivelit të lartë paraqiti shembuj të veprimtarive

ndërkombëtare ekzistuese dhe të planifikuara, ku përfshiheshin dhe ato me partnerët në Kroaci, Itali, Hungari dhe Rumani. **[Mbledhja 10] (Kapitulli III, Standardi III.4)**

### **Gjetjet**

#### **Praktika e mirë**

Ky ekip shqyrtues nuk identifikoi karakteristika të praktikave të mira në këtë Fushë Vlerësimi.

#### **Pikat e dobëta**

Grupi i vlerësimit nuk identifikoi asnjë dobësi në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

#### **Rekomandimet**

Grupi i vlerësimit nuk bëri asnjë rekomandim lidhur me këtë Fushë Vlerësimi.

#### **Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë në këtë Fushë Vlerësimi.

### **Gjykimi**

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përbushur plotësisht**.

## Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

- 2.1 UST ka një strukturë të qartë që përcakton përgjegjësitë për menaxhimin e burimeve në përputhje me kërkesat statutorë. Punësimi i personelit rregullohet si nga statutet e jashtme, ashtu edhe nga rregulloret e vetë Universitetit. Postet e lira akademike dhe administrative si dhe kriteret e punësimit paraqiten përmes faqes përkatëse të internetit. Stafi me kohë të pjesshme rekrutohet sipas nevojës për të mbuluar ngarkesën e mësimdhënies. Procesi i rekrutimit është i përcaktuar qartë. Të gjithë punonjësve u jepet një kontratë e përshtatshme, që mbahet në arkivin e Burimeve Njerëzore **[RVV 20&21; RVV 22&23; Ref 1.12&1.30; Mbledhjet 5-7]. (Kapitulli III, Standardi IV.1; Kapitulli III, Standardi II.2)**
- 2.2 UST-ja ka krijuar një ndjesi të fortë komuniteti dhe integrimi me stafin dhe studentët e vet. **[RVVf.21; Ref 2.7]** Stafi dhe studentët konfirmuan se veprimtaritë e përbashkëta të organizuara në nivel qendror, duke përfshirë pjesëmarrjen në panairë rekrutimi, aktivitete sociale dhe konkurse sportive, kanë ndihmuar që ata të integrohen plotësisht në komunitetin e Universitetit. **[Mbledhjet 3-7,10,11&13] (Kapitulli III, Standardi IV.2; Kapitulli III, Standardi IV.4)**
- 2.3 UST-ja ka procedura të përshtatshme për vlerësimin e efektshmërisë së stafit akademik. **[RVV f.21&22; Ref 2.11; Mbledhjet 7,10,11&13]** Procesi i vlerësimit mbështetet në një ndërthurje të vlerësimit të ofrimit të mësimdhënies përgjatë vitit akademik nga menaxherët e linjës të lektorëve dhe analizës së pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies. Marrëveshjet formale me industrinë sigurojnë mundësi që stafi të jetë vazhdimisht në dijeni të zhvillimeve në vendin e punës dhe atyre specifike për lëndën. Për marrjen e titullit Profesor vijon të jetë parakusht që pedagogët të kenë minimumi një përvojë njëvjeçare në mësimdhënie në një universitet perëndimor. UST-ja i ofron mbështetje dhe nxitje stafit të ri për të marrë pjesë në veprimtari ndërkombëtare. **[RVV f.21; Ref 2.14; Mbledhjet 7,10,11&13]** Bisedat me stafin kërkimor treguan se pritet që ata të botojnë një punim 'të mirë', të shqyrtuar nga kolegët, çdo vit. Duke vlerësuar përfitimet për stafin nga botimi i kërkimeve të tyre, por duke marrë në konsideratë se mbledhja e të dhënave mund të kërkojë kohë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti në përfundimin se politika e UST-së mund të kushtëzojë cilësinë e kërkimit që zhvillohet, si dhe mund të marrë shumë kohë nga koha e stafit. Prandaj, **rekomandohet** se UST-ja duhet të marrë në konsideratë shqyrtimin e përshtatshmërisë së synimeve aktuale të produkteve kërkimore të stafit në politikat ekzistuese të vlerësimit periodik të stafit. **(Kapitulli III, Standardi IV.3)**
- 2.4 UST-ja ka procedura transparente për menaxhimin e burimeve financiare. Procedurat janë në përputhje me kërkesat e menaxhimit financiar publik, dhe Ministrisë i dërgohet një raport. Buxhetet janë të centralizuara dhe kërkesat e departamenteve dhe fakulteteve shqyrtohen nga Rektorati para se të rishikohen nga Bordi i Administrimit dhe më pas të miratohen nga Senati Akademik. Menaxhimi financiar i përditshëm u është caktuar fakulteteve, për të ndihmuar realizimin e prioriteteve të identifikuara me mbështetjen e ofruar nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit. **[RVV f.23-25; Ref 2.23-2.25&2.27; Mbledhjet 7,10,11&13]** Në përputhje me kërkesat rregullatore dhe ligjore, UST-ja u nënshtrohet një sërë procesesh auditimi të brendshëm dhe të jashtëm. **[RVV f.24&25; Ref**

**2.27; Mbledhjet 7,10,11&13] (Kapitulli III, Standardi VI.1; Kapitulli III, Standardi VI.2; Kapitulli III, Standardi VI.3)**

- 2.5 UST-ja ka një sistem të integruar informacioni të mbështetur nga Politika e Komunikimit. **[RVV f.25; Ref 2.28]** Sistemi menaxhon informacionin e studentëve, që përfshin procesin e pranimit, materialet e të nxënësve dhe mësimdhënies, planet mësimore, informacionin e vlerësimit dhe informacione të tjera mbi kohën në Universitet. **[RVV f.25; Mbledhjet 3-7,10,11&13]** Teknologjia dhe sistemi i informacionit zhvillohen në vazhdimësi dhe, aktualisht, janë duke u përmirësuar me anë të krijimit të një baze të dhënash të studentëve. **[Mbledhjet 3-7,10,11&13]** Faqja e internetit e Universitetit paraqet informacion në gjuhën shqipe dhe atë angleze dhe, për të komunikuar me studentët, përdoren gjerësisht një sërë platformash rrjetesh sociale. **[Faqja e internetit e Universitetit; Mbledhjet 3-7,10,11&13] (Kapitulli III, Standardi VII.1)**
- 2.6 UST-ja ka infrastrukturë të përshtatshme të teknologjisë së informacionit që përmbush nevojat e personelit dhe studentëve. Interneti dhe Wi-Fi janë të disponueshme kudo në mjediset e universitetit. Ka një larmi të madhe të laboratorëve të praktikës që janë të pajisur me mjetet e specializuara për të mbështetur të nxënësve dhe ka një numër të përshtatshëm sallash kompjuteri në auditorë për të përmbushur nevojat e të nxënësve dhe studentëve. Gjatë pandemisë është zhvilluar mësimi online dhe Universiteti planifikon se kjo do të vazhdojë. Menaxhimi i sistemit të informacionit të universitetit për të siguruar se informacioni dhe të dhënat janë strategjike dhe të përshtatshme trajton plotësisht rekomandimin e dhënë pas vizitës së akreditimit institucional të muajit prill të vitit 2017. **[RVV f.26; Ref 2.22&2.33; Tur në burimet e të nxënësve; Mbledhjet 3-7,10,11&13] (Kapitulli III, Standardi VII.2)**
- 2.7 UST-ja ka një Politikë të miratuar të Menaxhimit të Pasurive, që përcakton qartë rolet dhe përgjegjësitë e menaxhimit për sa u përket pasurive. **[RVV f. 26&27; Ref 2.34]** Universiteti mban regjistra të detajuar të pasurive të paluajtshme, si dhe ka një vizion për zgjerim dhe ristrukturim. Kjo përfshin përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës së mësimdhënies, ku përfshihen pishinat, fusha e futbollit dhe palestra. **[RVV f.27; Mbledhjet 6&7,10,11&13; Tur në burimet e të nxënësve]** Zbatimi i Politikës së Menaxhimit të Pasurive trajton plotësisht rekomandimin e dhënë pas vizitës së akreditimit institucional të muajit prill 2017 se UST-ja duhet të sigurojë infrastrukturën e duhur në nivel universiteti për përmirësimin e kushteve të mësimdhënies dhe menaxhimin efikas të infrastrukturës për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. Raporti i Vetëvlerësimit shkruan se UST-ja ka infrastrukturën e nevojshme për të siguruar se objektet e mësimdhënies dhe mësimnxënies janë plotësisht të aksesueshme për të gjithë studentët. **[RVV f.9&27]** Turi në burimet e të nxënësve e konfirmoi këtë deklaratë që trajton plotësisht rekomandimin e bërë pas vizitës në kuadër të akreditimit institucional në prill të vitit 2017 se Universiteti duhet të hartojë dhe zbatojë një plan të caktuar për të siguruar se nxënësit me aftësi të kufizuara mund të aksesojnë të gjitha hapësirat e mësimdhënies dhe mësimnxënies. **(Kapitulli III, Standardi VII.3; Kapitulli III, Standardi VII.5; Kapitulli III, Standardi V.1)**
- 2.8 Ekziston një politikë e përshtatshme, që siguron ruajtjen, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë dhe kulturës akademike dhe asaj shkencore. **[RVV f.27]** UST-ja siguron zhvillimin e kulturës së vet përmes mbajtjes së programeve mësimore dhe literaturës përkatëse për të gjitha programet e studimit, publikimet si dhe librat mësimorë të hartuar



nga stafi akademik me kohë të plotë, në bibliotekë. **[RVV f.27; Ref 2.35; Mbledhjet 5-7&13; Tur në burimet e të nxënit] (Kapitulli III, Standardi VII.4)**

2.9 Raporti i Vetëvlerësimit përcakton se UST-ja, për shkak të pozicionit unik që ka, u ofron shërbime dhe ekspertizë një sërë institucioneve dhe organizatave të jashtme. **[RVV f.28; Ref 2.36]** Personeli i fakulteteve mbështetet për të punuar me projekte të financuara nga jashtë, me qëllim promovimin e veprimtarive mësimore dhe kërkimore të Universitetit. Objektet sportive të Universitetit janë në dispozicion të komunitetit vendas dhe federatave dhe klubeve sportive, në përputhje me pritshmëritë ligjore. **[Mbledhjet 5-7&13; Tur në burimet e të nxënit] (Kapitulli III, Standardi VII.6)**

2.10 UST-ja regjistron dhe mban të gjitha dokumentet zyrtare sipas kërkesave ligjore. **[RVV f.29; Ref 2.39]** Raporti i Vetëvlerësimit parashikon një objektiv zhvillimi institucional për të siguruar se i gjithë arkivi i UST-së do të digjitalizohet deri në fund të vitit 2021. **[RVV f.29]** Veprimi i ndërmarrë për të realizuar digjitalizimin e të gjithë arkivit të UST-së **ripohohet. (Kapitulli III, Standardi V.2)**

## **Gjetjet**

### **Praktika e mirë**

Ky ekip shqyrtues nuk identifikoi karakteristika të praktikave të mira në këtë Fushë Vlerësimi.

### **Pikat e dobëta**

Grupi i vlerësimit nuk identifikoi asnjë dobësi në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

### **Rekomandimet**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- UST-ja duhet të marrë në konsideratë shqyrtimin e përshtatshmërisë së synimeve aktuale të produkteve kërkimore të stafit në politikat ekzistuese të vlerësimit periodik të stafit. **(Kapitulli III, Standardi IV.3).**

### **Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë**

Grupi i vlerësimit të jashtëm pohoi veprimin e mëposhtëm të ndërmarrë:

- veprimi i ndërmarrë për të realizuar digjitalizimin e të gjithë arkivit të UST-së deri në fund të vitit 2021 **(Kapitulli III, Standardi V.2).**

## **Gjykimi**

Standardet për Burimet janë **përbushur plotësisht.**



### **Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula**

- 3.1 Në përputhje me misionin dhe objektivat e veta, UST-ja ofron programe specialiste për mësues, trajnerë dhe studiues në fushat e shkencave sportive, shkencave të lëvizjes dhe shëndetit, rekreacionit dhe turizmit aventuresk, si dhe shëndetit fizik e mendor. Programet ofrohen me kohë të plotë dhe të pjesshme në nivel universitar dhe me kohë të plotë në nivel pasuniversitar **[RVV f.31-33; Ref 1.25; Mbledhjet 5-7&13]** UST-ja mban kontakte me Drejtoritë Arsimore Rajonale, shkollat e mesme të përgjithshme dhe sportet profesioniste për të ndihmuar me përcaktimin e objektivave të programeve dhe krijon një sërë fletushkash informuese rreth programeve. **[RVV f.32; Ref 2.10]** Kriteret e pranimit të studentëve janë të përcaktuara qartë dhe procesi është i disponueshëm në faqen e internetit të institucionit. Të gjitha programet e studimit të ciklit të parë mundësojnë vazhdimin e studimeve në një program shkencor ose profesional të ciklit të dytë. Kalimi në studimet e nivelit të doktoraturës është po ashtu i mundshëm. Lëshohen suplemente diplome, ku përfshihen modulet e studiuara. UST-ja ofron module të zhvillimit të vazhdueshëm në fushat përkatëse, për t'u bërë të mundur të diplomuarve dhe profesionistëve të kenë njohuri të përditësuara. **[RVV f.32&33; Ref 3.7-3.11; Mbledhjet 5-7&13; Faqja e internetit e UST-së] (Kapitulli I, Standardi I.1; Kapitulli I, Standardi I.2; Kapitulli I, Standardi I.3; Kapitulli I, Standardi I.6)**
- 3.2 Programet e studimit janë hartuar në përputhje me procesin e Bolonjës në lidhje me strukturën, nivelin dhe kreditet. **[RVV f.34; Ref 3.4-3.6; Mbledhjet 3-7,11&13]** Programet e studimit marrin parasysh plotësisht politikat përkatëse kombëtare pasi përmbajtja e programit ofron mundësi mobiliteti për studentët dhe stafin. **[RVV f.34; Ref 2.1; Mbledhjet 3-7,11&13]** Studentët dhe stafi konfirmuan se mundësitë ndërkombëtare të mobilitetit janë të disponueshme dhe se në disa raste është e disponueshme edhe ndihma financiare. **[Mbledhjet 3-7&11]** Rregulloret e UST-së mundësojnë dhënien e një diplome të dyfishtë ose të shumëfishtë. **[RVV f.34; Ref 3.16] (Kapitulli I, Standardi I.4)**
- 3.3 Secili departament planifikon mësimdhënien çdo vit, sipas akteve nënligjore në fuqi, dhe raporton në fund të vitit për zbatimin kundrejt planit. Pritshmëritë e stafit akademik përcaktohen në kontratat individuale. **[RVV f.34&35; Ref 2.1&3.18; Mbledhjet 5,6&13]** Mësimdhënia shtesë nga stafi me kohë të plotë ose të pjesshme financohet nga Universiteti. Secili departament ka përgjegjësi të balancojë ngarkesën e detyrueshme të stafit lidhur me mësimdhënien me veprimtaritë që mbështesin kërkimin dhe institucionin në përgjithësi. Disa nga stafi akademik kanë detyra administrative dhe angazhimet individuale të mësimdhënies reduktohen në mënyrë proporcionale **[RVV f.35; Mbledhjet 5,6&13] (Kapitulli I, Standardi I.5)**
- 3.4 Kurrikulat e ciklit të parë iu ofrojnë studentëve njohuritë themelore dhe shkencën bazë të edukimit fizik, sportit dhe shëndetit. Kurrikulat janë strukturuar në mënyrë të tillë që të mundësojnë zhvillimin e njohurive shkencore të lidhura me disiplinën. **[RVV f.35&36; Ref 3.4-3.6]** Në faqen e internetit të UST-së gjendet informacion mbi programet, ku përfshihen edhe kriteret e qarta për përfundimin e një programi të ciklit të parë dhe kalimin në programet e ciklit të dytë, çka bën të mundur një kalim progresiv. **[RVV f.35&36; Ref 3.5]** Rregulloret e UST-së u bëjnë të mundur studentëve të transferojnë kreditet e fituara ndërmjet programeve dhe të transferohen në ose nga Universiteti. **[RVV f.36; Ref 2.1]** Të

diplomuarve u jepet suplementi i diplomës, që bën të qartë se të diplomuarit janë të gatshëm për punësim. **[RVV f.36; Mbledhjet 3-6,7&13] (Kapitulli I, Standardi I.7)**

- 3.5 Raporti i Vetëvlerësimit përcakton se filozofia e UST-së e orientuar nga studentët siguron se programet e ciklit të parë janë të hartuara për të lehtësuar përshtatjen e studentëve në mjedisin universitar. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni luan rol kyç në ndjekjen e ecursisë së studentëve nga fillesa e studimeve deri në diplomimin e, më pas, punësimin e tyre. Bordi i Administrimit mund të anulojë tarifën për atletët elitarë dhe studentët në nevojë. Rekrutimi i stafit akademik favorizon kandidatët të cilët janë specialistë në fushën e tyre dhe janë aktivë në mësimdhënie, kërkim dhe botim. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë zhvillon anketa me studentët për të marrë mendimet e tyre rreth metodave të mësimdhënies dhe shërbimit të ofruar nga njësitet administrative. **[RVV f.36; Ref 2.13,2.15&3.20; Mbledhjet 7,9&13] (Kapitulli I, Standardi I.8)**
- 3.6 Personeli akademik i përfshirë në hartimin dhe zhvillimin e programeve të ciklit të dytë është po ashtu i përfshirë në mënyrë aktive në veprimtari kërkimore ose shkencore, në mentorimin për temat e masterit ose disertacionet, punon në projekte me institucione të tjera të arsimit të lartë ose bashkëpunon me institucione të huaja. **[RVV f.37; Ref 3.25; Mbledhjet 4-6&13]** UST-ja ka ngritur një sërë bashkëpunimesh me federatat e sportit, organet qeveritare, organizatat e biznesit dhe universitetet ndërkombëtare, për t'u ofruar studentëve përvojë praktike në fushën e përzgjedhur. Praktika profesionale dhe projektet e diplomës përbëjnë pjesë thelbësore të programeve të ciklit të dytë. **[RVV f.37; Ref 1.23; Mbledhjet 4-6&13] (Kapitulli I, Standardi I.9)**
- 3.7 Kurrikulat e ciklit të dytë organizohen në module dhe kredite, që akordohen sipas Sistemit Evropian të Grumbullimit dhe Transferimit të Krediteve. **[RVV f.37&38; Ref 3.4-3.7]** Kështu, programet e studimit lehtësojnë mobilitetin e studentëve dhe stafit, si dhe bashkëpunimin me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Studentët e programeve të studimeve të ciklit të parë dhe të dytë i nënshtrohen një provimi të gjuhës së huaj në përputhje me ligjin për arsimin e lartë. Studentët që përfundojnë me sukses ciklin e parë dhe të dytë marrin një diplomë dhe suplement diplome në shqip dhe anglisht. **[RVV f.37&38; Ref 3.4-3.7; Mbledhjet 4-6&13] (Kapitulli I, Standardi I.10)**
- 3.8 Programet e studimit janë organizuar për të mundësuar zbatimin e teorisë në praktikë. Ka një larmi mundësish praktike, ku përfshihen orët e ushtrimeve, orët e laboratorit, orët e praktikës në palestra dhe projekte jashtë në terren. Studentët duhet të ndjekin 75 për qind të orëve praktike para se të vlerësohen. Të gjitha programet përfshijnë prezantimin e një teze. **[RVV f.38; Ref 2.1,3.4-3.7&3.20; Mbledhjet 4-6&13] (Kapitulli I, Standardi I.11)**
- 3.9 Programet në të tria ciklet i pajisin studentët me të kuptuarit dhe praktikën e profesionistëve në fushat e edukimit fizik dhe shëndetit, shkencat e lëvizjes dhe rekreacionit, turizmit aventuresk, shkencat e rehabilitimit fizik dhe shëndetit. **[RVV f.38&39; Ref 1.23,3.28&3.31; Mbledhjet 4-6&13]** Studentët u shprehën se stazhet janë një mënyrë e rëndësishme për përvetësimin e aftësive të zbatimit të teorisë në praktikë dhe aftësive të punësimin. **[Mbledhjet 3&4] (Kapitulli I, Standardi I.12)**

**Gjetjet**

**Praktika e mirë**

Ky ekip shqyrtues nuk identifikoi karakteristika të praktikave të mira në këtë Fushë Vlerësimi.

**Pikat e dobëta**

Grupi i vlerësimit nuk identifikoi asnjë dobësi në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

**Rekomandimet**

Grupi i vlerësimit nuk bëri asnjë rekomandim lidhur me këtë Fushë Vlerësimi.

**Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë pohim të veprimeve të ndërmarra në këtë Fushë Vlerësimi.

**Gjykimi**

Standardet për Kurrikulën janë **përbushur plotësisht.**

## **Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi**

- 4.1 Sikurse parashikohet nga rregulloret e UST-së, gjashtë muaj përpara fillimit të çdo viti akademik, departamentet rishikojnë programet e tyre dhe identifikojnë ato pjesë që kanë nevojë për më shumë përmirësim, përfshirë këtu listën e materialeve për lexim për secilin modul të programit. Procesi i rishikimeve të programeve të studimit nga departamentet vlerësohet nga stafi akademik. Një rezultat i dobishëm është se Universiteti siguron organizim të përshtatshëm dhe dokumentim të qartë në hartimin e çdo programi studimi. **[RVV f.40; Ref 2.1; Mbledhjet 2&5]** Krahas bibliotekës qendrore të universitetit në kampusin kryesor, edhe secili fakultet ka bibliotekë. Departamentet përkatëse garantojnë akses dhe saktësi informacioni për studentët. Universiteti arrin ta realizojë procesin mësimdhënës kryesisht në godinat e tij, ndonëse një pjesë e laboratorëve të tij ndodhen në zona të tjera dhe përdoren në përputhje me marrëveshjet e bashkëpunimit me punëdhënësit vendas. Ky bashkëpunim me institucionet vendore, qofshin ato publike ose private, është i mirëzhvilluar. Marrëveshjet me partnerët janë lidhur edhe për të nxënëit e bazuar në praktikë, duke u mbështetur në zhvillimin e rrjetit të punëdhënësve sipas fakulteteve dhe me universitetin në tërësi **[RVV f.40; Ref 2.1&2.35; Mbledhjet 2&5; Tur në burimet e të nxënëit] (Kapitulli I, Standardi II.1)**
- 4.2 Kriteret dhe kërkesat lidhur me vlerësimin përfundimtar të diplomimit përcaktohen në rregulloret e UST-së dhe miratohen nga strukturat përkatëse përgjegjëse dhe publikohen online në faqen e internetit të universitetit. Ankesat ose ankimimet lidhur me rezultatet e vlerësimit shqyrtohen nga një komision i ngritur në përputhje me rregulloret e posaçme dhe brenda afateve të miratuara. **[RVV f.40&41; Ref 2.1,&4.2; Mbledhjet 2&5]** Studentët mund të aksesojnë rezultatet e vlerësimit personal në mënyrë konfidenciale, duke përdorur një emër përdoruesi dhe fjalëkalim në sistemin Pitagora online. **[RVV f.41; Ref 3.4-3.6&4.4; Mbledhjet 2-5](Kapitulli I, Standardi II.2)**
- 4.3 UST-ja po punon drejt rritjes së cilësisë me përmirësimet e vazhdueshme që po bën në nivel departamenti, fakulteti dhe rektorati. Kjo vlerësohet dhe monitorohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si organ i pavarur. **[RVV f.41; Ref 1.2, Mbledhjet 2,5&7]** Ky proces mbështetet edhe me anë të informacionit të marrë nga anketime të ndryshme dhe monitorimi vjetor i programit, që përfshijnë vlerësimin e studentëve, vlerësimin e mësimdhënies, rezultatet e pyetësorëve dhe analizat e performancës së studentëve. Gjithashtu, kryhet dhe procesi i vlerësimit të stafit. Programet e studimit vlerësohen dhe përmirësohen gjatë mbledhjeve vjetore në fund të vitit akademik. **[RVV f.41; Ref 4.5; Mbledhjet 5&7] (Kapitulli I, Standardi II.3)**
- 4.4 Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies ruhet edhe me anë të mobilitetit të personelit, punësimit të personelit akademik, promovimit të personelit, lejet sabatike dhe angazhimit të personelit akademik në projekte kërkimi. Politikat e Sigurimit të Cilësisë miratohen nga Senati Akademik dhe publikohen në Statut, në rregulloret e departamenteve dhe në proceset vjetore të vlerësimit të departamenteve. UST-ja organizon grupe për kërkimin shkencor për përcaktimin e kriterëve për punësimin e personelit akademik me tituj akademikë përmes veprimtarive kërkimore. Strategjitë e departamenteve përfshijnë masa për fuqizimin e autonomisë së tyre dhe përmirësimin e veprimtarive kërkimore përkatëse. Universiteti përcakton standardet e rekrutimit të stafit akademik, kurse departamentet

përcaktojnë kritere të posaçme në varësi të specifikave të rekrutimit. **[RVV f.42; Ref 2.0,2.12,2.16,3.31,4.6&4.7; Mbledhjet 5&7] (Kapitulli I, Standardi II.4)**

4.5 Departamentet janë njësitë bazë të Universitetit dhe janë përgjegjëse për promovimin e veprimtarisë kërkimore të stafit. Veprimtaritë mësimore dhe kërkimore koordinohen dhe menaxhohen nga departamentet. Për të mbështetur më tej këtë fushë zhvillimi, Universiteti po nxit angazhimin dhe pjesëmarrjen në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare dhe rekruton personel akademik të kualifikuar në fushën e kërkimit shkencor. Prioritetet e kërkimit dhe financimi diskutohen në nivel departamenti dhe qendre kërkimi. Propozimet parashtrihen për t'u marrë në konsideratë dhe miratuar nga Rektorati. Në fillim të çdo viti akademik, stafit i kërkohet të identifikojë nevojat për pajisje dhe mjete të tjera të nevojshme për zhvillimin e mësimin dhe veprimtarisë kërkimore dhe të mbështesë dhe promovojë pjesëmarrjen e studentëve në kërkim. Institucioni bashkëpunon me institucione të tjera kërkimore publike ose private, dhe inkurajon dinamikat e këtij komponenti të rëndësishëm, duke përmirësuar cilësinë e procesit mësimor dhe cilësinë e kërkimit shkencor. **[RVV f.42; Ref 1.2,2.25,2.26,3.4,3.6,4.8,4.9,4.11&4.12; Mbledhjet 5&7](Kapitulli II, Standardi I.1; Kapitulli II, Standardi I.2; Kapitulli II, Standardi I.5)**

4.6 UST-ja mbështet dhe promovon kërkimin shkencor në fushën e sportit dhe ndërkombëtarizimin përmes marrëveshjeve dhe pjesëmarrjes në projekte me partnerë të ndryshëm. Përmes programit Mobiliteti i Krediteve të Erasmus +, Universiteti bashkëpunon me universitetet publike dhe private në Shqipëri dhe Evropë, si dhe ka ngritur rrjete partnerësh. Ndërkombëtarizimi përmes marrëveshjeve me institucionet e tjera dhe pjesëmarrjes në projekte është një nga prioritetet kryesore të Institucionit dhe konsiderohet si një karakteristikë e **praktikës së mirë**. **[RVV f.44; Ref 1.23,2.14,4.15&4.16; Mbledhjet 5&7] (Kapitulli II, Standardi I.3)**

4.7 Personeli dhe studentët mbështeten kur marrin pjesë në konferenca shkencore. Pjesëtarëve individualë të personelit u caktohet kohë e posaçme për kërkimin në brendësi të ngarkesës mësimore vjetore që ata kanë. Çdo vit, stafit i kërkohet të paraqesë punën përkatëse në të paktën një konferencë shkencore të brendshme ose të botojë një artikull shkencor në një revistë, ndërkohë që përdoren edhe rrjetet dhe mediat sociale për të paraqitur rezultatet e kërkimeve. **[RVV f.44; Ref 1.6,2.13&4.17; Mbledhjet 5&7] (Kapitulli II, Standardi I.4)**

4.8 Strategjia e zhvillimit dhe objektivat afatgjata të Institucionit përqendrohen te veprimtaritë kërkimore dhe shkencore. UST-ja merr pjesë në hartimin dhe zbatimin e politikave shkencore rajonale dhe kombëtare, që publikohen në faqen zyrtare të internetit. Universiteti fton staf akademik të huaj për mbajtjen e leksioneve të hapura ose përfshirjen si lektorë me kohë të pjesshme dhe siguron integrimin e plotë të individëve në komunitetin e Universitetit. Lektorët inkurajohen të marrin pjesë në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe lektorëve që synojnë të zhvillojnë kërkim shkencor afatgjatë, u ofrohen mundësi lejeje. **[RVV f.45; Ref 1.22-1.25,1.34,4.13&4.19; Mbledhjet 5&7] (Kapitulli II, Standardi I.6)**

4.9 UST-ja mbështet organizimin dhe zhvillimin e seminareve, konferencave dhe veprimtarive të kërkimit shkencor. Rezultatet kërkimore publikohen në revista shkencore dhe faqen e internetit. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë monitoron dhe vlerëson ecurinë e

veprimtarisë kërkimore dhe shkencore. Universiteti mbron pronësinë intelektuale në përputhje me ligjet në fuqi. Kërkuesit e rinj motivohen dhe ndihmohen të ndërmarrin nismat e tyre në fushat e kërkimit. **[RVV f.46; Ref 2.14,2.16,3.3,4.14,4.15,4.21; Mbledhjet 5&7] (Kapitulli II, Standardi I.7; Kapitulli II, Standardi I.8)**

## **Gjetjet**

### **Praktika e mirë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë në këtë Fushë Vlerësimi:

- ndërkombëtarizim përmes marrëveshjeve me institucione të tjera dhe pjesëmarrjes në projekte **(Kapitulli II, Standardi I.3)**

### **Pikat e dobëta**

Grupi i vlerësimit nuk identifikoi asnjë dobësi në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

### **Rekomandimet**

Grupi i vlerësimit nuk bëri asnjë rekomandim lidhur me këtë Fushë Vlerësimi.

### **Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë pohim të veprimeve të ndërmarra në këtë Fushë Vlerësimi.

## **Gjykimi**

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur plotësisht.**



## **Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe mbështetja e tyre**

- 5.1 Pranimi i studentëve kryhet në përputhje me kriteret dhe kuotat e miratuara për çdo program studimi. Për mirëpritjen e studentëve të rinj, Universiteti organizon ditë të hapura (Ditët e Orientimit të Karrierës) për çdo vit akademik, detajet e së cilave publikohen në faqen e internetit të UST-së. Në fillim të secilit vit akademik, stafi i fakultetit organizon takime me studentët e rinj për t'u prezantuar, për të shpjeguar programin e studimit dhe Sekretaria Mësimore i orienton studentët drejt burimeve dhe vendeve të duhura. Institucioni ka një politikë të hapur për studentët e huaj. **[RVV f.48; Ref 2.1,2.9,3.1&5.1-5.3; Mbledhjet 3,5&6] (Kapitulli I, Standardi III.1)**
- 5.2 UST-ja ka ngritur Komisionin e Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët (KMVMS). Komisioni shërben për përkrahjen e studentëve dhe trajtimin e problemeve të tyre në organet përkatëse. Studentët konfirmuan se KMVMS-ja është një zhvillim i efektshëm dhe i mirëpritur dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e identifikoi këtë si një karakteristikë të **praktikës së mirë**. Institucioni ka krijuar një formë të komunikimit të brendshëm përmes faqes së internetit, platformave mësimore, rrjeteve sociale dhe veçanërisht sistemit ESS3/Pitagora, që lejon një komunikim midis studentëve dhe personelit akademik dhe administrativ, ku ata mund të ndajnë dhe shkëmbejnë mes tyre materiale në mënyrë individuale ose në grupe. Dosja personale e çdo studenti ruhet në zyrën e Sekretarisë Mësimore. Kjo dosje përditësohet gjatë periudhës së studimit, për shembull, duke përfshirë detajet për praktikën profesionale dhe temën e diplomës. **[RVV f.48&49; Ref 2.1,2.9,3.20,3.21,5.1-5.3,5.5&5.6; Mbledhjet 3,5,6&9] (Kapitulli I, Standardi III.2; Kapitulli I, Standardi III.3)**
- 5.3 Universiteti ndjek politika për mbështetjen e studentëve nga komunitetet rome dhe egjiptiane me aftësi të kufizuara ose me prindër invalidë. Në mbështetje të kësaj, UST-ja ofron kuota në programet e studimit për këto kategori të veçanta, duke siguruar dhe mbështetje financiare lidhur me tarifat e studimit ose bursa. Mbështetja është dëshmuar nëpërmjet infrastrukturës së askesueshmërisë në mjediset e Universitetit. UST-ja mbështet dhe financon pjesëmarrjen e studentëve në veprimtari kulturore dhe sportive, përmes tarifave të anëtarësimit, financimit të uniformave, transportit dhe shpenzimeve të tjera. **[RVV f.49&50; Ref 5.7-5.11; Mbledhjet 3,5,6&9] (Kapitulli I, Standardi III.4)**
- 5.4 Universiteti bën të disponueshme materialet e leximit në formën e librave shkollorë, të cilët miratohen nga secili departament. UST-ja ka një bibliotekë qendrore bashkëkohore, që u mundëson studentëve materialet e duhura për nevojat e tyre shkencore. Fondi i bibliotekës synon të pasurojë bibliotekën me botime të reja librash shkollorë për të përmbushur nevojat e programeve të studimit dhe, bazuar në regjistrat e fundit të blerjeve, fondi i bibliotekës ka arritur pasurimin e burimeve. Përveç librave fizikë, Universiteti ka edhe një librari online. **[RVV f.50; Ref 2.25,2.35&5.12; Mbledhjet 5,6&9] (Kapitulli I, Standardi III.5)**
- 5.5 Në fillim të çdo viti akademik, Universiteti u ofron studentëve mentorim, veçanërisht gjatë punës praktike dhe hartimit të temës së diplomës në të gjitha ciklet e studimit. Studentëve u ofrohet tutorim dhe mentorim individual në përputhje me rregulloret e Universitetit. Stafi akademik, kryesisht lektorët, por edhe punonjësit e tjerë të departamentit, ndihmojnë dhe udhëzojnë studentët në kërkimin e literaturës së përshtatshme për temën e tyre të

diplomës. Universiteti cakton mentorues për diplomën për t'iu përshtatur temës dhe programit të studimit të studentëve. UST-ja po përpiket të gjejë mënyra për zbatimin e projektidesë 'Studenti për studentin', ku studentët me rezultatet më të larta do të ndihmojnë studentët e tjerë në nevojë dhe ky veprim është **pohuar**. [RVV f.50-51; Ref 2.1&3.29; Mbledhjet 5,6&9] (Kapitulli I, Standardi III.6)

5.6 UST-ja i inkurajon studentët të përfaqësohen në strukturat universitare dhe studentët janë të përfaqësuar në mbledhjet në nivel institucional dhe fakulteti, dhe po ashtu janë ngritur edhe Këshillat Studentorë në nivel fakulteti dhe Universiteti. Në mbështetje të një rekomandimi të bërë pas vizitës në kuadër të akreditimit institucional në prill të vitit 2017 se Universiteti duhet të sigurojë mbështetje financiare për veprimtaritë e Këshillit Studentor, Raporti i Vetëvlerësimit shprehte se, për vitin 2021, është planifikuar se mbështetja financiare për veprimtaritë e studentëve do të pesëfishohet krahasuar me vitin 2019. [RVV f.10; Ref 5.a&5.b] Mbështetja financiare ndaj Këshillave Studentorë të Universitetit dhe Fakulteteve trajton plotësisht rekomandimin e bërë pas vizitës së akreditimit institucional në muajin prill 2017. Nga diskutimet me studentët dhe stafin u konstatua se UST-ja, së bashku me studentët dhe KVMMS-në, është duke krijuar një Këshill Studentor të ri dhe ky veprim **pohohet**. Studentët gëzojnë të drejtën të shprehin mendimet dhe shqetësimet e tyre për çështje që lidhen me ecurinë e procesit të të nxënit, përfshirë këtu të drejtën për të shprehur mendimin e tyre lidhur me kalendarët e provimeve. Studentët nxiten shpeshherë të marrin pjesë në jetën institucionale dhe akademike të Universitetit. [RVV f.51; Ref 1.2,2.19&5.13; Mbledhjet 5,6&9] (Kapitulli I, Standardi III.7)

5.7 Universiteti ofron mbështetje për të lehtësuar jetën kulturore studentore, duke përfshirë dhe mbështetje financiare të rritur. Bordi i Administrimit i lejon studentët të përdorin të gjitha objektet sportive pa pagesë jashtë procesit mësimor. Infrastruktura fizike përbush të gjitha kriteret e nevojshme të sigurisë dhe shëndetit. [RVV f.51; Ref 2.21,5.14&5.15; Mbledhjet 5,6&9] (Kapitulli I, Standardi III.8)

5.8 Një rekomandim i dhënë pas vizitës së akreditimit institucional në muajin prill 2017, parashikon se UST-ja duhet të ndërtojë dhe krijojë një bazë të dhënash gjithëpërfshirëse dhe të përhershme për ndjekjen e punësimit të të gjithë studentëve të diplomuar. Departamenti i Këshillimit të Karrierës dhe Alumni ka krijuar një bazë të dhënash të studentëve të diplomuar. Megjithatë, nga diskutimet me stafin, u konstatua se krijimi i plotë i bazës së të dhënave është në proces dhe se veprimi i ndërmarrë për ngritjen e plotë të një baze efektive të dhënash të të diplomuarve në UST **pohohet**. Krahas punës praktike të posaçme për programin, UST-ja organizon workshop-e dhe panaire pune për t'i njohur studentët me tregun e punës. [RVV f.51&52; Ref 1.23,1.31&5.16; Mbledhjet 5,6&9] (Kapitulli I, Standardi III.9)

## Gjetjet

### Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë në këtë Fushë Vlerësimi:

- ngritje e Komisionit të Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët për të përkrahur studentët dhe për të trajtuar problemet e tyre në organet përkatëse (**Kapitulli I, Standardi III.2; Kapitulli I, Standardi III.3**).

#### **Pikat e dobëta**

Grupi i vlerësimit nuk identifikoi asnjë dobësi në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

#### **Rekomandimet**

Grupi i vlerësimit nuk bëri asnjë rekomandim lidhur me këtë Fushë Vlerësimi.

#### **Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë**

Grupi i vlerësimit të jashtëm pohoi veprimin e mëposhtëm të ndërmarrë:

- zbatimin e propozuar të projektidesë 'Studenti për studentin' ku studentët me rezultatet më të larta do të ndihmojnë studentët e tjerë në nevojë (**Kapitulli I, Standardi III.6**)
- veprimi i ndërmarrë për të ngritur një Këshill Studentor të ri (**Kapitulli I, Standardi III.7**)
- veprimi i ndërmarrë për të krijuar plotësisht një bazë të dhënash efektive të të diplomuarve në UST (**Kapitulli I, Standardi III.9**).

#### **Gjykimi**

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur plotësisht**.

## Lista e evidencave

### Lista 1

Dokumentet në këtë listë janë dorëzuar nga institucioni për të shoqëruar raportin e vetëvlerësimit dhe për t'u shfaqur në sistemin e menaxhimit ASCAL gjatë fazës së vetëvlerësimit të procesit. Në raport, këto dokumente referohen si **Ref R.1.a, Ref 1.1**, etj.

### Rekomandimet

- R.1.a Vendimi i Senatit për ngritjen e NJSBC-së/EN.
- R.1.b Vendimi i Senatit për emërimin e këshilltarëve/EN.
- R.1.c Vendimi i Senatit për zënien e vendeve të lira në NJSBC/EN.
- R.2.a Kontratë Shërbimi 1/AL.
- R.2.b Kontratë Shërbimi 2/AL.
- R.2.c Marrëveshja me Rrjetin Akademik Shqiptar/AL.
- R.2.d.1 Formulari i standardizuar i të dhënave të punonjësve/AL.
- R.2.d.2 Formulari i standardizuar i të dhënave të studentëve/AL.
- R.2.d.3 Vendimi i Rektoratit për miratimin e modelit për ngarkesën e mësimdhënies/EN.
- R.2.d.4 Urdhri i përbashkët për miratimin e modelit për formularin e tarifës së studimit/EN.
- R.2.d.5 Urdhri i brendshëm i Administratorit për miratimin e formularit standard të prokurimit/EN.
- R.2.d.6 Urdhri i brendshëm i Administratorit për miratimin e formularit standard të bursave/EN.
- R.2.e Marrëveshja e bashkëpunimit me Universitetin e Biznesit dhe Teknologjisë/AL.
- R.3.a Vendimi i Senatit për miratimin e kuotave të pranimit/AL.
- R.3.b.1 VKM nr. 40, datë 23.01.2019/AL.
- R.3.b.2 VKM nr. 39, datë 23.01.2019/AL.
- R.3.c Dëshmi fotografike të infrastrukturës për personat me aftësi të kufizuar.
- R.4.a Të dhëna mbi investimin për infrastrukturën/EN.
- R.4.b Dëshmi fotografike për infrastrukturën e planifikuar.
- R.5.a Vendimi i Bordit të Administrimit për miratimin e ndryshimeve në strukturë/EN.
- R.5.b Raporti për Alumnit/EN.
- R.6.a Vendimi i Bordit të Administrimit nr. 22 për detajimin e të ardhurave/AL.
- R.6.b Vendimi i Bordit të Administrimit nr. 29 për detajimin e të ardhurave/AL.
- R.6.b.1 Grafiku për fondet për veprimtaritë studentore/EN.

### Fusha e Vlerësimit 1

- 1.1 VKM nr. 57, datë 29.01.2020 për Statusin e Veçantë/AL.
- 1.2 Statuti i UST-së/EN.
- 1.3 Rregulloret e UST-së/EN.
- 1.4 Rregulloret e Senatit Akademik/EN.
- 1.5 Rregulloret e Bordit të Administrimit/EN.
- 1.6 Rregulloret e Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik/EN.
- 1.7 Rregulloret e Komisionit për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Botimeve dhe Projekteve Shkencore/EN.
- 1.8 Rregulloret e Komisionit të Kurrikulave/EN.
- 1.9 Rregulloret e Komisionit të Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët/EN.
- 1.10 Rregulloret për Këshillin e Etikës/EN.
- 1.11 Rregulloret për Zgjedhjet/AL.
- 1.12 Lista e vendimeve të Senatit Akademik/EN.

- 1.13 Dëshmi e përqindjes së pjesëmarrësve në zgjedhje/AL.
- 1.14 Dëshmi pamore e thirrjeve për personelin.
- 1.14.a Dëshmi pamore e thirrjeve për studentët.
- 1.15 Lista e konferencave/EN.
- 1.15.a Vendimi i Rektorit për organizimin e konferencave/AL.
- 1.15.b Shembull i procesit të konferencave/AL.
- 1.15.c Vendimi i Bordit të Administrimit mbi tarifën e konferencave/AL.
- 1.16 Shembull i shpalljes së mbledhjes së Senatit Akademik/AL.
- 1.16.a Shembull i shpalljes së mbledhjes së Bordit të Administrimit/AL.
- 1.17 Shembull se si vendimet e Senatit Akademik bëhen publike/AL.
- 1.17.a Shembull se si vendimet e Bordit të Administrimit bëhen publike/AL.
- 1.18 Shembull i procesverbalit nga një mbledhje departamenti/AL.
- 1.19 Shembull i thirrjes për propozime për Planin Buxhetor Afatmesëm/AL.
- 1.19.a Shembull i thirrjes për propozime për Planin Strategjik/AL.
- 1.20 Rregullore për sigurimin e cilësisë/EN.
- 1.20.a Manuali i Njësisë së Sigurimit të Cilësisë/EN.
- 1.21 Rregulloret për Njësinë e Kurrikulave/EN.
- 1.22 Tabela e projekteve ndërkombëtare/EN.
- 1.22.a Tabela e projekteve kombëtare/AL.
- 1.22.b Pjesëmarrja e studentëve në projekte kërkimore/AL.
- 1.23 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit/EN.
- 1.23.a Marrëveshja e bashkëpunimit me Institutin Danez të Studimeve Sportive/EN.
- 1.23.b Marrëveshja e Bashkëpunimit me WBS/EN.
- 1.23.c Marrëveshja e bashkëpunimit për praktikën profesionale/AL.
- 1.23.d Dëshmi e organizimit të konferencave të përbashkëta/EN.
- 1.24 Plani Strategjik 2016-2020/EN.
- 1.25 Plani i Zhvillimit Strategjik 2021-2026/EN.
- 1.26 Strategjia e Ndërkombëtarizimit 2021-2023/EN.
- 1.27 Strategjia e Kërkimit Shkencor 2020-2025/EN.
- 1.28 Shembull i raportit vjetor institucional/AL.
- 1.29 Shembull i raportit vjetor të fakulteteve/AL.
- 1.30 Organigrama/EN.
- 1.31 Dëshmi e takimeve të punës me palët e interesit të tregut të punës/AL.
- 1.31.a Studim i tregut të punës përpara hapjes së një programi Bachelor/AL.
- 1.31.b Studim i tregut të punës përpara hapjes së një programi Master/AL.
- 1.32 Për ndjekjen e rezultateve të studentëve në provimet e licensimit/EN.
- 1.33 Dëshmi nga faqja e internetit.
- 1.34 Tabela e mobiliteteve/EN.
- 1.34.a Lista e lektorëve të ftuar/AL.
- 1.35 Dëshmi fotografike nga leksionet e hapura.

## Fusha e Vlerësimit 2

- 2.1 Rregulloret e Njesisë Kryesore të FSHL/EN.
- 2.2 Rregulloret e Njesisë Bazë, Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit/EN.
- 2.3 Rregulloret e rekrutimit të personelit akademik, personelit akademik mbështetës në UST/EN.
- 2.3.a Paketa e rekrutimit të komisionit ad hoc/EN.
- 2.3.b Formulari i aplikimit për rekrutimin si personel akademik me kohë të plotë/pjesëshme/EN.
- 2.4 Shpallja e vendeve të lira në UST/AL.
- 2.5 Procedura e kërkesës për shpalljen/rishpalljen e vendeve të lira/AL.
- 2.5.a Procedura e plotë për rekrutimin e personelit akademik me kohë të pjesëshme/AL.
- 2.5.b Procedura për rekrutimin e personelit administrativ/AL.
- 2.6 Ankimimi i vlerësimit të aplikimit të rekrutimit/AL.
- 2.7 Procedura e miratimit dhe mbështetjes për pjesëmarrjen e personelit akademik në trajnime/AL.
- 2.8 Broshura e 60-vjetorit të UST-së/AL.
- 2.9 Manuali i Studentëve/EN.
- 2.10 Procedura e miratimit dhe mbështetjes për pjesëmarrjen e personelit akademik në veprimtari promovimi (ditë të hapura)/AL.
- 2.10.a Dëshmi fotografike të pjesëmarrjes së personelit akademik në veprimtari promovimi.
- 2.10.b Dëshmi fotografike të takimit informues me studentët e vitit të 1-rë.
- 2.10.c Procedura e miratimit dhe mbështetjes për pjesëmarrjen e personelit akademik në aktivitete shkencore/AL.
- 2.11 Raport informimi i CPAB-së për numrin e personelit akademik me tituj dhe grada akademike/AL.
- 2.12 Grupi i instrumenteve të cilësisë/EN.
- 2.13 Procedura e plotë për aplikimin dhe akordimin e Titullit Akademik të Profesorit/AL.
- 2.14 Dëshmi e procedurës së plotë për marrjen e miratimit dhe mbështetjes financiare për botimin në revista shkencore/AL.
- 2.14.a Procedura e miratimit dhe mbështetjes financiare për pjesëmarrjen e personelit akademik në konferenca ndërkombëtare/AL.
- 2.14.b Procedura e miratimit dhe mbështetjes financiare për pjesëmarrjen e grupeve të personelit akademik në konferenca ndërkombëtare/AL.
- 2.15 Procedura e miratimit dhe mbështetjes financiare për pjesëmarrjen e delegacionit të personelit akademik në simpoziume ndërkombëtare/AL.
- 2.15.a Procedura e miratimit dhe mbështetjes financiare për pjesëmarrjen e delegacionit të personelit akademik në workshop-e projektsh ndërkombëtare/AL.
- 2.16 Shembull i anketës së NJSBC-së për Studentët/EN.
- 2.16.a Raporti i NJSBC-së për anketën e studentëve/AL.
- 2.17 Dëshmi fotografike të revistës zyrtare të UST-së.
- 2.18 Dëshmi fotografike për aktivitetet sociale të personelit të UST-së.
- 2.18.a Dëshmi fotografike për aktivitetet sociale të personelit të UST-së (festa e Vitit të Ri për fëmijët).
- 2.18.b Vendimi i Rektorit për organizimin e festës së daljes në pension/AL.
- 2.19 Dëshmi fotografike nga veprimtaritë socio-kulturale të studentëve.
- 2.20 Vendimi për angazhimin e stafit në përvjetorin e 60-të/AL.
- 2.20.a Dëshmi fotografike nga ceremonia e përvjetorit të 60-të/AL.
- 2.20.b Dëshmi fotografike nga diplomimi.

- 2.21 Vendimi i Bordit të Administrimit për shërbimet e ofruara për personelin dhe studentët/AL.
- 2.22 Shembuj të kontratave të punës/AL.
- 2.22.a Shembull i listës së kontrollit të dosjes së personelit/AL.
- 2.23 Shembull i procedurës së miratimit të planit buxhetor afatmesëm/AL.
- 2.24 Rregullore për financat/EN.
- 2.25 Vendimi i Bordit të Administrimit për detajimin e të ardhurave/AL.
- 2.26 Vendim i Bordit të Administrimit për miratimin e planit të buxhetit/AL.
- 2.27 Shembull i raportit të auditimit/AL.
- 2.27.a Shembull i planit të veprimit të marrë pas raportit të auditimit/AL.
- 2.28 Pamje nga llogaria e Sekretarit në Pitagora.
- 2.29 Pamje nga faqja e internetit.
- 2.30 Pamje nga mediat sociale.
- 2.31 Pamje nga llogaria e Studentëve në Pitagora.
- 2.32 Doracak i lektorëve për përdorimin e Teams/AL.
- 2.33 Doracak i personelit akademik për mësimin në distancë/AL.
- 2.34 Të dhëna mbi infrastrukturën/AL.
- 2.34.a Politika e menaxhimit të aseteve/EN.
- 2.35 Lista e koleksioneve të bibliotekës/AL.
- 2.36 Dëshmi të angazhimit të personelit akademik në funksionet këshillimore në MASR/AL.
- 2.37 Certifikata e higjienës dhe pastërtisë/AL.
- 2.38 Certifikata nga Shërbimet e Mbrojtjes nga Zjarri/AL.
- 2.39 Raport mbi arkivimin e dokumenteve/EN.

### **Fusha e Vlerësimit 3**

- 3.1 Dëshmi numerike për studentët e UST-së/EN.
- 3.2 Dëshmi e atletëve elitare që ndjekin studimet në UST/EN.
- 3.3 Rregullore për studimet e doktoraturës/EN.
- 3.4.a Programi i studimit Bachelor/Urdhri i hapjes/AL.
- 3.4.b Programi i studimit Bachelor/Urdhri i akreditimit/AL.
- 3.4.c Programi i studimit Bachelor/kurrikula/AL.
- 3.4.d Programi i studimit Bachelor/Diploma dhe suplementi i diplomës/EN.
- 3.4.e Programi i studimit Bachelor/Rregulloret e programit të studimit/EN.
- 3.4.f Programi i studimit Bachelor/programi mësimor/EN.
- 3.4.g Programi i studimit Bachelor/CV/EN.
- 3.4.a Programi i studimit Bachelor/Urdhri i hapjes/AL.
- 3.4.b Programi i studimit Bachelor/Urdhri i akreditimit/AL.
- 3.4.c Programi i studimit Bachelor/kurrikula/AL.
- 3.4.d Programi i studimit Bachelor/Diploma dhe suplementi i diplomës/EN.
- 3.4.e Programi i studimit Bachelor/Rregulloret e programit të studimit/EN.
- 3.4.f Programi i studimit Bachelor/programi mësimor/EN.
- 3.4.g Programi i studimit Bachelor/CV/EN.
- 3.5.a Programi i studimit Master Profesional/Urdhri i hapjes/AL.
- 3.5.b Programi i studimit Master Profesional/Urdhri i akreditimit/AL.
- 3.5.c Programi i studimit Master Profesional/Kurrikula/AL.
- 3.5.d Programi i studimit Master Profesional/Diploma dhe suplementi i diplomës/EN.
- 3.5.e Programi i studimit Master Profesional/Programi mësimor/EN.
- 3.5.f Programi i studimit Master Profesional/Programi mësimor/EN.
- 3.5.g Programi i studimit Master Profesional/CV/EN.
- 3.6.a Programi i studimit Master Shkencor/Urdhri i hapjes/AL.
- 3.6.b Programi i studimit Master Shkencor/Urdhri i akreditimit/AL.
- 3.6.c Programi i studimit Master Shkencor/Kurrikula/AL.

- 3.6.d Programi i studimit Master Shkencor/Diploma dhe suplementi i diplomës/EN.
- 3.6.e Programi i studimit Master Shkencor/Programi mësimor/EN.
- 3.6.f Programi i studimit Master Shkencor/Programi mësimor/EN.
- 3.6.g Programi i studimit Master Shkencor/CV/EN.
- 3.7 Shembull i procedurës për kriteret e pranimit të studentëve/AL.
- 3.8 Shembull i procedurës për kuotat e pranimit të studentëve/AL.
- 3.9 Rregullore për testin fizik të pranimit/AL.
- 3.9.a Udhëzime për testin fizik të pranimit/AL.
- 3.10 Shembull i procedurës së pranimit në programet e studimit të ciklit të dytë/AL.
- 3.11 Paketa ligjore e moduleve të edukimit në vazhdim/AL.
- 3.12 Raport për projektin Teavet/EN.
- 3.13 Shembull i pjesëmarrjes në aktivitete të edukimit në vazhdim/AL.
- 3.14 Shembull i personelit akademik që janë pjesë e Komisionit të Provimit Shtetëror të Licensimit/AL.
- 3.15 Broshurë informuese mbi projektin BOLALBA Tempus/EN.
- 3.16 Broshurë informuese mbi projektin Tempus SPEED/EN.
- 3.17 Shembull i planifikimit të ngarkesës mësimore të detyrueshme dhe ngarkesë mësimore shtesë/AL.
- 3.17.a Shembull i raportimit të ngarkesës mësimore të përfunduar/AL.
- 3.18 Shembull i marrëveshjes vjetore të punës/AL.
- 3.19 Shembull i pagesës së ngarkesës mësimore shtesë/AL.
- 3.20 Dokument i caktimit të personelit administrativ në Sektorin e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni/AL.
- 3.21 Dokument i caktimit të personelit administrativ për të ndihmuar studentët me platformat mësimore/AL.
- 3.22 Shembull i procedurës së krijimit të njërive të këshillimit të karrierës në nivel fakulteti/AL.
- 3.23 Vendimi i Bordit të Administrimit për studentët që përjashtohen nga tarifa e studimit/AL.
- 3.24 Vendimi i Bordit të Administrimit për studentët që përfitojnë përgjysmim të tarifës së studimit/AL.
- 3.25 Shembull i procedurës së rishikimit të kurrikulave/AL.
- 3.26 Rregulloret e transferimit të studimeve/EN.
- 3.27 Shembull i praktikës së transferimit/AL.
- 3.28 Rregulloret e praktikës së mësimdhënies/EN.
- 3.28.a Paketa e vlerësimit të praktikës së mësimdhënies/EN.
- 3.29 Rregulloret e diplomimit/EN.
- 3.30 Rregulloret e programeve në mjedis të jashtëm/AL.
- 3.30.a Dëshmi fotografike nga programet në mjedis të jashtëm.
- 3.31 Dëshmi e ambienteve laboratorike/AL.

#### **Fusha e Vlerësimit 4**

- 4.1 Rregulloret e provimeve/EN.
- 4.2 Shembull i kalendarit të provimeve/AL.
- 4.3 Shembull i listës së notave/AL.
- 4.4 Doracaku për Pitagora/AL.
- 4.5 Shembull i një raporti vjetor të hartuar nga departamenti/AL.
- 4.6 Politika e Sigurimit të Cilësisë/EN.
- 4.7 Shembull procedure për ngritjen e NJSBC-së në nivel fakulteti/AL.
- 4.8 Shembull procedure për caktimin e përgjegjësve të lëndëve/AL.
- 4.9 Shembull i një kërkesë financiare për zhvillimin e një lënde/AL.
- 4.10 Shembull i planifikimit të kërkimit shkencor/AL.
- 4.11 Formular aplikimi për projekte shkencore/EN.



- 4.12 Shembull i një raporti vjetor për mësimdhënien dhe veprimtaritë kërkimore të personelit akademik/AL.
- 4.13 Marrëveshje bashkëpunimi me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë/AL.
- 4.14 Lista e aktiviteteve të kërkimit shkencor për 2017-2020/EN.
- 4.15 Shembull i analizës vjetore të punës së kërkimit shkencor të zhvilluar nga personeli akademik/AL.
- 4.15.a Lista e botimeve në revista shkencore për 2017-2020/EN.
- 4.16 Dëshmi fotografike nga seancat e posterave të studentëve.
- 4.17 Shembull i platformës së kërkimit shkencor/EN.
- 4.18 Shembull i formularit për vlerësimin e projekteve/EN.
- 4.19 Shembull i mbështetjes financiare për projektet shkencore/AL.
- 4.20 Shembull i mbështetjes ndaj personelit akademik që ndjek studimet e doktoraturës/AL.
- 4.21 Dëshmi fotografike nga workshop-et e studentëve.
- 4.22 Shembull i organizimit të një veprimtarie të shkollës verore.

### **Fusha e Vlerësimit 5**

- 5.1 Doracak i Teams për studentët/AL.
- 5.2 Doracak i studentëve për mësimin në distancë/AL.
- 5.3 Fletushka informuese/AL.
- 5.4 Rregulloret e Këshillit Studentor/EN.
- 5.5 Shembull procedure për ngritjen e këshillave studentorë/AL.
- 5.6 Rregullore e Zyrës së Sekretarit/EN.
- 5.7 Dëshmi numerike e kategorive të studentëve të përjashtuar nga tarifat e studimit/AL.
- 5.8 Dëshmi e mbështetjes financiare për veprimtaritë sportive studentore/AL.
- 5.9 Kalendari i veprimtarive sportive të organizuara nga Federata Shqiptare e Sportit Universitar/AL.
- 5.10 Dëshmi fotografike nga aktivitetet sportive.
- 5.11 Mbështetja financiare për studentët për pjesëmarrjen në kampionate sporti/AL.
- 5.12 Rregulloret e bibliotekave/EN.
- 5.13 Shembull i procedurës se si institucioni shqyrton tarifat e studimit me kërkesë të studentëve/AL.
- 5.14 Mbështetja financiare për studenten Fiona Huta/AL.
- 5.15 Mbështetja financiare për studentin Mario Zilli/AL.
- 5.16 Dëshmi fotografike nga seancat e praktikës profesionale.

### **Shtojcat**

- Shtojca Tabelat Institucionale.
- Shtojca Tabela e Masterit Shkencor.
- Shtojca Tabela e Masterit Profesional.
- Shtojca Tabela e Programit Bachelor.

## **Mbledhjet e zhvilluara gjatë vizitës**

Në raport, mbledhjeve u referohen duke përdorur shkurtime **Mbledhja 1, Mbledhja 2**, etj:

### **Dita 1: E enjte 24 qershor, 2021**

- 09:00 - 09:15 Mbledhja 1: Grupi i vlerësimit të jashtëm takon Koordinatorin Institucional
- 09:15 - 09:45 Mbledhja 2: Grupi i vlerësimit të jashtëm takon Rektorin
- 10:00 - 11:00 Mbledhja 3: Grupi i vlerësimit të jashtëm takon një grup studentësh të ciklit të parë
- 11:15 - 12:15 Mbledhja 4: Grupi i vlerësimit të jashtëm takon një grup studentësh të ciklit të dytë
- 12:30 - 13:30 Mbledhja 5: Grupi i vlerësimit të jashtëm takon një grup të stafit akademik.
- 14:30 - 15:30 Mbledhja 6: Grupi i vlerësimit të jashtëm takon një grup të stafit mbështetës.
- 15:45 - 16:30 Mbledhja 7: Grupi i vlerësimit të jashtëm takon Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

### **Dita 2: E premte, 25 qershor 2021**

- 09:00 - 09:15 Mbledhja 8: Grupi i vlerësimit të jashtëm takon Koordinatorin Institucional
- 09:15 - 10:15 Mbledhja 9: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon përfaqësues të Qendrës së Karrierës dhe Orientimit.
- 10:30 - 11:30 Mbledhja 10: Grupi i vlerësimit të jashtëm takon drejtuesit e lartë
- 11:45 - 12:15 Mbledhja 11: Mbledhja me partnerë të jashtëm dhe alumni
- 12:15 - 12:30 Mbledhja 12: Grupi i vlerësimit të jashtëm takon Rektorin
- 12:30 - 13:30 Mbledhja 13: Grupi i vlerësimit të jashtëm takon Grupin e Vetëvlerësimit
- 13:45 - 14:30 Mbledhja 14: Tur në burimet e të nxënit.